



SBASHK Arsimimi sot

Korrik, 2023

Gazeta elektronike

U përmbyll me sukses aktiviteti tradicional në bregdetin shqiptar Respekt meritot për angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë



Pas përgatitjeve të bëra me përkushtim nga koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, stafi qendror dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve kishte nisur së realizuari me sukses aktiviteti tradicional për pushim të një numri të konsideruar të anëtarëve të SBASHK –ut në bregdetin shqiptar...(faqe 4)

SBASHK-u në Kongresin e 9-të virtual botëror të Edukimit
Internacional

**Forcimi i sindikatave, solidariteti dhe ruajtja e
demokracisë**



Ka filluar më 11 korrik punimet Kongresi i 9-të...(faqe 5)

SBASHK-u në Konferencën ndërkombëtare për
inteligjencën artificiale në arsim

**Askush nuk mund ta zëvendësojë mësuesin në
procesin arsimor e edukativ**



Sindikata e Arsimit të Bullgarisë ...(faqe 7)


SBASHK në Kongresin
e Sindikatës së Arsimit të
Bullgarisë

**Të 25 sindikatat mysafire të
përkushtuara për solidaritet
e bashkëpunim**

Në Sofje është mbajtur
Kongresi ...(faqe 8)

Bisedë me ata që u angazhuan
për rrjedhën e pushimeve në
Durrës

**Ndjehemi mirë kur
kuptojmë se ishim në krye
të detyrës**



Organizimi i pushimeve për
...(faqe 3)

Editorial

Hekuran u mundove të shkatërrosh sindikatat, përballu tash me drejtësinë



Hekuran Murati pa as edhe një dije intelektuale për të qenë Ministër i Financave, por edhe i punës e mirëqenies sociale e për t'u dëshmuar se edhe sjelljet e një rrugaçi i pranon për të mbetur në ligën e parë të Albinit, kishte nisur fushatë tmerri ndaj sindikatave e në veçanti të sindikatës SBASHK, që ruan krenarinë për misionin e shenjtë të pishtarëve të dijes kundër errësirës që po mundohej ta mbillte në këto troje pushtuesi serb e që ky mision ruhet në faqet e historisë e prezantohet me heroin e shkollës shqipe drejtorin në Strellc, Haki Pavataj, me bacën Adem Haxhiajdini e me 400 pishtarët të dijes që dhanë jetën për liri.

Hekuran në kohën kur unë Rrahman Jasharaj, njëri nga këta mësuesit e viteve të 90-ta dhe njëri nga veprimtarët sindikalë që i thamë JO Serbisë dhe jetuam me pak bukë që na jepte populli ynë dhe me fjalën e tij të entuziazmit, po udhëheqja një grevë të lejuar me Ligjet e Kushtetutën e Kosovës e pasi që Qeveria jote injoronte e përbuzte kërkesat tona legjitime dhe kërkesën modeste për t'u takuar me shefin tënd tekanoj,

ti dole në parlament e në media dhe gënjeve se unë paskam keqpërdorur mjetet e akumuluar nga anëtarësia, si buxhet i vetëm yni. Duke mos dashur ta dish të vërtetën e pastër si loti se si akumulohen e si shpërndahen e administrohet me ato mjete bëre apel publik të prokuroria e shtetit që të nis hetimet. E bëre për të ndikuar në opinion e sidomos për t'ju dhënë edhe ca plumba fyes ndaj meje ushtrisë së Albinit për të më fyer e për të më paraqitur edhe si hajn. Turp e turpi ju mbuloftë se unë erdha në SBASHK për të udhëhequr me këtë sindikatë që mbrojti arsimin shqip në vitet e historisë sonë nga furtunat e pushuesit me betimin e premtimin dhënë punëtorëve të arsimit se do të ruaj figurën e mësuesit dhe pishtarëve të dijes. Ti e di cilën përgjigje ta dha para ca muajve prokuroria lidhur me gënjeshtren e shpifjen tënde për mjetet në SBASHK dhe unë nuk dola të krekosem para medieve se me ju nuk ndjej më arsye të flase të ballafaqohem se jeni hiçi i hiçit, por lexova te "Betimi për drejtësinë" se tani ti je ai që po ftohesh para drejtësisë. Ky nuk është rasti i parë që do të ftohesh se të kemi bërë tri kallëzime penale duke i besuar institucioneve të drejtësisë dhe e vërteta do të dal sheshit. Unë para se të nisem në rrugëtimin tim i jam betuar familjes, kolegeve e kolegëve që punuan më misionin e shenjtë të edukimit të brezave dhe gjakut të dëshmorëve, që me emblemën e UÇK-së, i sollën lirinë këtij trualli dhe zërin shqip të ziles në shkollat e Kosovës se do të vazhdoj të jem i ndershëm e ti kush je dhe kush do të jesh?

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.


Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Bisedë me ata që u angazhuan për rrjedhën e pushimeve në Durrës
Ndjehemi mirë kur kuptojmë se ishim në krye të detyrës



Ishin bërë me kohë gjithë përgatitjet për të realizuar ashtu si duhet aktivitetin tradicional për pushimet e një numri të konsideruar të anëtarëve të SBASHK-ut. Në komunikim të përditshëm të koordinatorit për organizim të brendshëm

Ymer Ymeri, stafit qendror dhe të kryetarëve të kuvendeve sindikale komunale e të universiteteve po përgatiteshin listat definitive dhe pastaj duke mbajtur komunikim edhe me stafin e “Bonita” u punua edhe për akomodimin dhe rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti. Pushuesit ishin ndarë në tri grupe dhe duhej kujdes meritë që ata të kalonin mirë e të ktheheshin me përshtypje të shkëlqyera nga bregdeti shqiptar. Në këtë numër të gazetës po përcjellim bisedat që i zhvilluam me ata që janë më të merituarit për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti tradicional. Ata janë koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe përgjegjësit e angazhuar në të tri grupet Lumnija, Nezi, Marigona, Tafili, Hakiu, Sabiti, Ahmeti, Vlora, Blendori, Ruhani e Afrimi.

Ymeri:

Jam shumë i lumtur që pas gjithë atyre angazhimeve ky aktivitet u përmbyll me sukses të plotë dhe ndjehem mirë kur lexojmë përshtypjet e anëtarëve të SBASHK-ut, që këtë vit pushuan në ambientet e mrekullueshme të “Bonita”. Respekt pushuesve për qëndrimin e dinjitetshëm, respekt për pronarin dhe stafin e Kompleksit Hotelier “Bonita”. Besoj se edhe bitin e ardhshëm do të jemi bashkë.

Lumnija:

Ishte nder për mua që më ishte besuar detyra që të jem në ekipin e mrekullueshëm të atyre që do të kujdeseshin për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti tradicional. Dukej se është detyrë e vështirë, por fal bashkëpunimit me gjithë ekipin e falë edhe sjelljes plot dinjitet të pushuesve arritëm ta përmbyllim me sukses këtë aktivitet dhe krenohem me ato që lexojmë në fletoret e përshtypjeve

Nezi:

Ditët e bukura në bregdetin shqiptar shoqëruar me gjithë atë freski për SBASHK-un të pushuesve, që janë anëtarë të sindikatës sonë nga e tërë Kosova, vallet e kënga e kënduar bashkë na bënë që të ndjehemi krenar që na u besua detyra që të kujdesimi për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti. Bashkë e në këtë atmosferë do të jemi edhe sot e gjithmonë.

Marigona:

Ishim bashkë në këtë aktivitet dhe ndjeheshim edhe më mirë sepse me ne qëndronte edhe kryetari Jasharaj që na jepte kurajë e na falënderonte për angazhimet tona. Mësuesi i Kosovës, anëtar i SBASHK-ut, tregoi se është me plot dinjitet dhe i përgëzoj për këtë dhe ndjehem krenar me ta.

Tafili

Kur ma besuan detyrën që të jem pjesë e ekipit që do të angazhohej për mirëvajtjen e këtij aktiviteti tradicional pata fillimisht stres sepse në bregdetin shqiptar do të pushonin 450 anëtarë të SBASHK-ut. Mirëpo ky stres u tret me fillimet e pushimeve në “Bonita”. Jemi kujdesur të jemi në krye të detyrës dhe jam krenar për kontributin tim që ky aktivitet përfundoi ashtu si duhet. Në festa e gëzime u takofshim gjithmonë. Të lumtë SBASHK.

Hakiu:

Është nder kur SBASHK ta beson një detyrë si kjo. Kam bërë gjithë angazhimet për ta arsyetuar besimin. Ato që thuhet në fletoret e përshtypjeve më bëjnë krenar dhe më tregojnë se unë dhe kolegët e mij kemi qenë në nivel të detyrës.

Sabiti:

Ky aktivitet tradicional i SBASHK-ut u ka mundësuar pishtarëve të dijes që për disa ditë të heqin streset e të pushojnë në ambientet e mrekullueshme të “Bonita” e në detin e bukur shqiptar. Unë jam krenar që kontribuova sado pak që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë.

Ahmeti :

Ndjehem krenar për besimin që stafi qendror i SBASHK-ut më besoj. U mundova dhe besoj që e kam arsyetuar besimin. Ky aktivitet është njëri nga shumë angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. SBASHK jeni krenaria jonë.

Vlora:

Kemi bërë me kohë gjithë përgatitjet me stafin qendror e bashkë me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve për të pasur rrjedhë të mbarë ky aktivitet tradicional i SBASHK-ut dhe jemi krenar që ashtu edhe ndodhi. Ndjehemi mirë kur lexojmë përshtypjet e pushuesve nga të tri grupet që këtë vit ishin në bregdetin shqiptar. SBASHK-u do të vazhdojë me angazhimet në shërbim të anëtarësisë.

Blendori:

Që nga dita e parë jemi angazhuar maksimalisht në stafi qendror dhe të ndihmuar edhe nga veprimtarë të angazhuar nga komuna të ndryshme të Kosovës kemi arritur ta përmbyllim me sukses të plotë edhe këtë aktivitet.



SBASHK-u ishte dhe mbetet zë i anëtarësisë dhe do të vazhdojë rrugëtimin për mbrojtjen dhe realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Kishim ditë e muaj plot sfida, por bashkërisht e me unitetin e fuqishëm nuk ka sfida që nuk do t'i tejkalojmë.

Ruhani:

Ndjehem mirë që SBASHK më besoj këtë detyrë dhe besoj se e kam kryer këtë detyrë ashtu si duhet. Jam ndjerë

krenar me vlerësimin që më kanë bërë pushuesit dhe stafi qendror i SBASHK-ut.

Afrimi:

Kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyer dhe i kemi ndihmuar njëri-tjetrit. Gëzohem që pushuesit kanë kaluar mirë dhe kanë shprehur falënderim e respekt për SBASHK-un dhe për të gjithë neve që ishim angazhuar që ky aktivitet të zhvillohet ashtu si duhet.

Gjatë muajit

U përmbyll me sukses aktiviteti tradicional në bregdetin shqiptar Respekt meritot për angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë

Pas përgatitjeve të bëra me përkushtim nga koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, stafi qendror dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve kishte nisur së realizuari me sukses aktiviteti tradicional për pushim të një numri të konsideruar të anëtarëve të SBASHK –ut në bregdetin shqiptar.



Pushuesit ishin të ndarë në tri grupe. Dy grupet e para realizuan këtë aktivitet në qershor, ndërsa grupi i tretë ishte në bregdetin shqiptar në fillimet e muajit korrik



Ishin anëtare e anëtarë të SBASHK-ut nga Fushë Kosova, Shtërpca, Shtimja, Hani i Elezit, Gjilani, Kaçaniku, Lipjani, Novobërda, Obiliqi, Podujeva, Vitia, Prishtina, Skenderaj, Drenasi, Malisheva, Suhareka, Gjakova, Mamusha, Peja dhe Prizreni që përbenin grupin e tretë prej 183 pushuesve e që kishin arritur dielën e 2 korrikut në Kompleksin hotelier “Bonita” duke realizuar kështu në tërësi këtë aktivitet tradicional të pushimeve për vitin 2023.

Pushuesit me të arritur te Kompleksi Hotelier “Bonita”



janë takuar me kryetarin Jasharaj dhe pastaj koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me kujdestarët dhe stafin e “Bonita” janë përkujdesur për akomodimin e tyre.



Pushuesit kanë drekuar dhe pastaj, si me nxitim, janë drejtuar drejt plazhit dhe detit shqiptar. Shumë nga ata kanë gjetur kohë për t'u takuar me kryetarin e SBASHK-ut dhe pas bashkëbisedave kanë bërë edhe foto për t'i ruajtur si kujtim nga ky aktivitet.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Pushuesit pas kthimit nga plazhi uleshin në ambientet e jashtme të Hotelit dhe duke pirë ndonjë kafe a pije freskuese kthenin kujtimet në vitet e shkuara duke përmendur edhe kohët e studimeve e duke rrëfyer pastaj edhe për momente e ngjarje të caktuara gjatë punës së tyre edukativo-arsimore.



Ata që pak më të moshuarit flisnin me shumë krenari për angazhimet sublimë në vitet e 90-ta për të ruajtur e mbrojtur arsimin shqip nga tendencat dhe sulmet e pushtuesit. Këta pishtarë të dijes flisnin me krenari për ato vite të vështira dhe falënderonin SBASHK-un për angazhimet e atyre

viteve, por edhe të gjithë viteve deri tani për të radhatur pastaj arritjet e shumta e duke cekur se është uniteti që e bën të fortë SBASHK-un.



Meritor për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti tradicional e shumë domethënës janë koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe përgjegjësit e angazhuar në të tri grupet Lumnija, Nezi, Marigona, Tafili, Hakiu, Sabiti, Ahmeti, Vlora, Blendori, Ruhani e Afrimi.

SBASHK-u në Kongresin e 9-të virtual botëror të Edukimit Internacional Forcimi i sindikatave, solidariteti dhe ruajtja e demokracisë

Ka filluar më 11 korrik punimet Kongresi i 9-të Virtual Botëror i Edukimit Internacional me temën “Rritja e sindikatave tona, ngritja, lartësimi i profesioneve tona, mbrojtja e demokracisë”.



SBASHK-u në këtë ngjarje të rëndësishme për arsimin botëror ka marrë pjesë me katër delegatë me të drejtë vote. Ky është Kongresi i parë botëror që po mbahet virtualisht.



Në ditën e parë të Kongresit, përveç fjalës hyrëse të krytares së EI-së, znj. Susan Hopgood dhe Raportit të Progresit të Sekretarit të Përgjithshëm z. David Eduards, u bë edhe miratimi i agjendës që kishin të bënin me Raportin e Komisionit të Kredencialeve, miratimin e rregullave gjatë debateve në Kongres dhe Miratimit të një klauzole në lidhje me kohët e krizave si amendament i Kushtetutës dhe akteve nënligjore.



Dita e parë e Kongresit është përmbyllur me diskutimin për Raportin e Progresit të Sekretarit të Përgjithshëm, për të vazhduar në dytën e dytë të Kongresit me përgjigjet ndaj këtij diskutimi dhe tema tjera të rëndësishme sindikal.




Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Në ditën e dytë të Kongresit të 9-të Virtual Botëror të Edukimit Internacional Sekretari Përgjithshëm David Eduards ka prezantuar raportin e progresit. Pas diskutimeve të disa delegatëve lidhur me raportin dhe pasi që Sekretari i përgjithshëm Eduards u është përgjigjur edhe pyetjeve të shtriuara katër delegatët e SBASHK-ut së bashku me gjithë delegatët tjerë nga e mbarë bota në mënyrë unanime e kanë votuar këtë raport.




Pas kësaj Kongresi ka vazhduar punimet me shpalesjen e raportit nga kryetari i komisionit për financa lidhur me pasqyrat financiare 2019-2022. Pas diskutimeve të disa prej delegatëve edhe ky raport në mënyrë unanime u votua nga delegatët e Kongresit.



Dita e dytë ishte më e ngjeshur duke votuar e miratuar gjitha pikat sipas rendit të ditës. Ndër to ishin edhe: miratimi i rezolutës që mundëson zgjatjen e mandatit të auditorëve të jashtëm si dhe miratimi i rezolutës që mundëson vazhdimin e mandatit të komitetit të auditimit të brendshëm. Edhe këto dy rezoluta u votuan në mënyrë unanime nga delegatët e Kongresit.



Pastaj fjalën e mori Sekretari i Përgjithshëm z.Eduards me prezantimin e Programit dhe Buxhetit për vitin 2024, dhe propozimin e normës së tarifave/kuotave. Propozimi i Sekretarit të Përgjithshëm për programin e buxhetin dhe normën e tarifave për vitin 2024 hapi diskutim të frytshëm tek delegatët dhe nesër në ditën e tretë dhe përmbyllëse të Kongresit pritet që Sekretari i Përgjithshëm z.Eduards të bëjë një përmbledhje të diskutimeve dhe pastaj të kalohet në votimin e këtij planifikimi buxhetor për vitin 2024.



Në ditën e tretë dhe të fundit, delegatët u angazhuan me entuziazëm për të vazhduar angazhimin e tyre me fushatën e EI-së “Bëhu Publik! Financo Arsimin”, e cila u bën thirrje qeverive të investojnë më shumë në arsimin publik dhe mësuesit, faktor ky i vetëm dhe më i rëndësishëm në arritjen e arsimit cilësor.



Sekretari i Përgjithshëm i Edukimit Internacional, z.Eduards pas përmbledhjes së diskutimeve të ditës paraprake dhe duke përmendur edhe njëherë se ky program dhe buxhet njëvjeçar do të lejojë që EI të funksionojë siç duhet dhe të udhëheq aktivitete të shumta derisa Kongresi Botëror i EI-së të mbledhet përsëri në korrik të vitit 2024. Të gjithë delegatët në mënyrë unanime e votuan buxhetin njëvjeçar. Pikë e rendit të ditës ishte edhe prezantimi i tekstit të thjeshtuar të Kushtetutës dhe akteve nënligjore nga kryetari i këtij Komisioni. Pas disa debateve nga delegatët e Kongresit edhe kjo pikë e rendit të ditës kaloi me votim unanimit.





Ndër tjerash z.Eduards shtoi se është i bindur se “një sistem i fortë arsimor publik nuk është i pashmangshëm. Duhet të luftohet dhe të mbrohet. Tani në vitin tonë të 30-të, së bashku, kemi ndërtuar dijen, reputacionin, fuqinë dhe aleancat në nivelin më të lartë për të qenë një forcë, jo vetëm për arsimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, por edhe për vetë demokracinë. Falë jush, ne vazhdojmë ta bëjmë të ndihet ndikimi ynë dhe udhëheqja jonë më e fortë.”



Kryetarja e EI-së, znj.Susan Hopgood, në fjalën e saj përmbyllëse falënderoi delegatët për pjesëmarrjen e tyre, për durimin dhe kontributin, për kohën dhe vëmendjen e tyre gjatë këtyre tre ditëve të Kongresit: “Prania juaj në internet është një deklaratë e përhershme” shtoi ndër tjerash znj.Hopgood.

Ajo përfundoi: “Ju keni përfaqësuar shumë mirë 32 milionë edukatorët në 381 sindikata në 178 vende në këtë Kongres Botëror dhe mezi pres t’ju shoh personalisht vitin e ardhshëm në Kongresin e 10-të Botëror në Buenos Aires, Argjentinë”, është shprehur presidentja Hopgood.



SBASHK-u në Konferencën ndërkombëtare për inteligjencën artificiale në arsi **Askush nuk mund ta zëvendësojë mësuesin në procesin arsimor e edukativ**

Sindikata e Arsimit të Bullgarisë ka organizuar Konferencën ndërkombëtare “Inteligjenca artificiale në arsim”. Në këtë ngjarje të rëndësishme për arsimin kanë marrë pjesë përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe të 24 sindikatave tjera të arsimit nga shtete të Ballkanit dhe Evropës.



Pjesëmarrësit i kanë përshëndetur kryetarja e Sindikatës së Arsimit të Bullgarisë Janka Takeva dhe drejtoresha e përgjithshme e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës Suzan Flocken.



Pas kësaj ekspertë të teknologjisë kanë prezantuar analiza lidhur me temën duke u pajtuar se edhe për kundër zhvillimeve të hovshme teknologjike askush nuk mund ta zëvendësoj mësuesin në angazhimet e tij e në misionin për edukimin dhe arsimimin e brezave.

Në kuadër të kësaj konference ndërkombëtare janë hapur dhe debate për rolin e mësuesit në misionin e vështirë për edukimin dhe arsimimin e brezave dhe debatues nga shtete të ndryshme kanë sjellë fakte e argumente se profesioni i mësuesit gjithnjë e më tepër po ha në sfida të reja të kohës dhe nuk po gëzon mbështetjen e përkrahjen e institucioneve të shteteve në Ballkan e Evropë.



SBASHK në Kongresin e Sindikatës së Arsimit të Bullgarisë

Të 25 sindikatat mysafi e të përkushtuara për solidaritet e bashkëpunim

Në Sofje është mbajtur Kongresi i tetë i Sindikatës së Arsimit të Bullgarisë. Mysafirë të kësaj ngjarje me rëndësi për arsimin bullgar ishin drejtoresha e përgjithshme e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Suzan Flocken, përfaqësuesit e SBASHK-ut , të 24 sindikatave të arsimit nga shtete të Ballkanit e Evropës dhe ministra të Qeverisë bullgare.



Në hapje të Kongresit kryetarja e Sindikatës së Arsimit të Bullgarisë „Janka Takeva“ ka përshëndetur mysafirët dhe delegatët e Kongresit duke u shprehur se mysafirët duhet të ndjehen si në shtëpinë e tyre sepse janë sindikalistë të shkëlqyer dhe miq të vërtetë të sindikatës ,që ajo drejton.

Drejtorja e përgjithshme e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Suzan Flocken ka përshëndetur delegatët dhe mysafirët e kongresit për të përgëzuar znj.Takeva , veprimtarët dhe gjithë sindikalistët e arsimit bullgar për angazhimet dhe arritjet. Kongresi i



janë drejtuar me fjalë përshëndetëse edhe disa nga ministrat , të cilët kanë shprehur respektin për këtë sindikatë dhe gatishmërinë për të vazhduar me bashkëpunimin.




Në kuadër të aktiviteteve gjatë Kongresit përfaqësuesit e SBASHK janë takuar me drejtoresha e përgjithshme të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës Suzan Flocken,dhe me përfaqësues të Sindikatës së Arsimit të Sllovenisë e të shumë sindikatave tjera.

Të gjithë janë shprehur të përkushtuar për solidaritet dhe bashkëpunim. Duke shprehur respektin e lartë për përfaqësuesit e 25 sindikatave mysafire në këtë ngjarje të veçantë veprimtarët të sindikatës së arsimit të Bullgarisë kanë organizuar takime të shumta , por edhe vizita në pjesët më të bukura turistike e historike të këtij shteti. Po ashtu ishte mbresëlënëse prezantimi i shkëlqyer i korit të nxënësve të shkollave të mesme dhe i ansambleve të valleve e këngëve autoktone bullgare, që u bënë pjesë e këtij aktiviteti katër ditor.


Lexuam me kujdes përshtypjet e pushuesve në bregdetin shqiptar

Respekt e falënderime për SBASHK-un, të kënaqur me kushtet në “Bonita”

Gjatë gjithë ditëve të pushimvet në bregdetin shqiptar kryetari Jasharaj, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe përgjegjësit e angazhuar në të tri grupet Lumnija, Nezi, Marigona, Tafili, Hakiu, Sabiti, Ahmeti, Vlora, Blendori, Ruhani e Afrimi kanë zhvilluar biseda me pushuesit për të parë se cilat janë përshtypjet e tyre, por edhe për të marrë ndonjë ide të re për pushimet e radhës. Shumë nga pushuesit i kanë lënë të shkruara dhe ato ruhen me kujdes në selinë e SBASHK-ut. Staf i lexon këto përshtypje për të parë se çfarë thonë koleget e kolegët tanë, cilat janë vlerësimet e tyre për këtë aktivitet, për kushtet e ofruara në “Bonita”, por për të parë nëse pushuesit kanë dhënë edhe ide të reja me qëllim që ky aktivitet të pasurohet me diçka të re. Një grup pushuesish të pasionuar në lojën e shahut kanë propozuar që në vitin e ardhshëm në kuadër të ditëve të pushimit SBASHK-u të organizojë gara në shah.



përgjegjësve të caktuar nga SBASHK në njërën anë dhe mikpritja e ngrohtë e stafit të “Bonita” kanë bërë që të



Duke përgatitur këtë numër të gazetës “Arsimimi sot” ne anëtarët e redaksisë lexuam me kujdes përshtypjet e shumë prej anëtarëve të SBASHK-ut, që ishin si pjesë e grupit të parë, të dytë apo të grupit të tretë në bregdetin shqiptar dhe fragmente nga këto përshtypje po sjellim të ju lexues të nderuar.

“Organizimi i shkëlqyer dhe përkushtimi i përgjegjësve të caktuar nga SBASHK në njërën anë dhe mikpritja e ngrohtë e stafit të “Bonita” kanë bërë që të përjetojmë momente të paharruara nga ky pushim”, ka shkruar një anuare e SBASHK-ut nga Prishtina.

“Ky është njëri nga angazhimet dhe aktivitetet shumë të qëlluara të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. Vlerë e madhe e këtij aktiviteti është edhe komunikimi e bashkëbiseda me kolege e kolegë nga pjesë të

ndryshme të Kosovës për sfidat në arsim e duke këmbëyer ide për punë e angazhime në misionin për edukimin e arsimimin e brezave”, kishte shkruar një pushuese tjetër. Një pushues nga Mitrovica është shprehur se kushtet në “Bonita” për pushime kanë qenë të shkëlqyera. Ai pastaj falënderon stafin e SBASHK-ut për angazhimet në shërbim të anëtarësisë duke shtuar se me këtë aktivitet tradicional duhet vazhduar sepse punëtorët e arsimit një dhuratë si kjo. “Isha me fat që kolegët e koleget në shkollën time që përzgjedhën mua që të jem pjesë e këtij aktiviteti të SBASHK-ut”, ishte shprehur një tjetër pushues. Fletoret e përshtypjeve ruhen me kujdes në selinë e SBASHK-ut dhe përshtypjet e falënderimet e këtyre anëtarëve të SBASHK-ut na bëjnë që të vazhdojmë me angazhimet e përkushtimin duke pasur udhë rrëfim moton tonë Bashkë e në SBASHK.

